



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 636 / Prot.  
4

Tiranë më 27.05.2019

VENDIM

Nr. 13, datë 27.05.2019

PËR KONTROLLUESIN "SPITALI RAJONAL DURRËS"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 121, datë 19.04.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 08.05.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", konstaton se:

1. Kontrolluesi, nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të përmbush Kontrolluesi, përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë, pra që në momentin e fillimit të aktivitetit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar: "...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "d", të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Kontrolluesi, ka hartuar një rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale". Megjithatë, duhen marrë masa konkrete përsa i përket ambienteve të kartotekës, të cilat duhet të reflektojnë standardet e parashikuara në nenet 13 dhe 14, të Rregullores.

Në ambientet e kartotekës nuk aplikohet një rregullim, përsa i përket masave organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale të kartelave mjekësore nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale. Gjithashtu, konstatohet mungesa e një rregullimi të qartë lidhur me aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar.

Gjithashtu, përsa i përket sistemit të video-survejjimit CCTV, DVR-ja ndodhej në një sallë të veçantë e cila aksesohet vetëm nga personeli i IT-së, por kushtet nuk garantonin mbrojtje nga dëmtimet apo shkatërrimet aksidentale. Në lidhje me këtë konstatim, Kontrolluesi nuk ka një Rregullore specifike për monitorimin e sistemit të video-survejjimit (CCTV) në të cilën të parashikonte rregullime të qarta.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi dhe përdorimi nga nëpunësit e tij të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre. **Për këtë arsye duhet jo vetëm të hartohet një rregullore e detajuar, por edhe kjo rregullore të hartohet në përputhje me aktivitetin që ushtron kontrolluesi dhe të jetë e zbatueshme në praktikë duke reflektuar masa konkrete, sipas standardit të parashikuar.**

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pika 2/1: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

3. Kontrolluesi, ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti", në zbatim të Vendimit nr.06/2013, të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale", me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit.



4. Kontrolluesi disponon një sistem video- survejimi (CCTV), qëllimi i përdorimit të të cilit është garantimi i sigurisë në ambientin e punës. Konstatohet se kontrolluesi informon subjektet e të dhënave "vizitorë", "pacient" etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejit (CCTV) nëpërmjet tabelave. Megjithatë, këto tabela nuk janë sipas standardit të parashikimit në Udhëzimit nr.03/2010, të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

5. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë portalin [www.srd.gov.al](http://www.srd.gov.al). Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Ndaj këtij kontrolluesi është kryer hetim administrativ i mëparshëm dhe Zyra e Komisionerit me Vendimin nr.21, datë 13.05.2016, ka vendosur:

1. Dënimi i kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 dhe 22 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
2. Dënimi i kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
3. Kontrolluesi "Spitali Rajonal Durrës", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
4. Kontrolluesi "Spitali Rajonal Durrës", të marrë masa duke krijuar kushte të përshtatshme teknike dhe organizative për ruajtjen e dokumentacionit fizik të kartelave shëndetësore të pacientëve në arshivën fizike, në zbatim të Udhëzimit nr.23, të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë";
5. Kontrolluesi "Spitali Rajonal Durrës", të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit, sipas Vendimit nr.06, datë 05.08.2013, brenda një periudhe prej 30 ditësh.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 08.05.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se: *“U njoftuam për konstatimet e procesverbalit dhe brenda 5 ditëve, këto konstatime dhe detyra do të sillen me shkresë zyrtare, sipas ligjit”*.

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, kontrolluesi *“Spitali Rajonal Durrës”* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 22.05.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancën dëgjimore, ku ka paraqitur edhe pretendimet me shkrim se:

*“Spitali Rajonal Durrës, pasi ka administruar Procesverbalin e datës 08.05.2019 me konstatimet përkatëse, ka vepruar duke plotësuar në mënyrë të menjëhershme mangësitë e fiksuara në këtë akt, konkretisht:*

- a) Ka plotësuar “Formularin e Njoftimit”, sipas formatit të kërkuar dhe ia ka komunikuar Institucionit tuaj me shkresën nr.828/3 Prot., datë 17.05.2019;*
- b) Ka bërë ndryshimet në portalin e tij zyrtar duke reklamuar Politikën e Privatësisë, duke përfshirë në të edhe “Njoftimin mbi ruajtjen e privatësisë”;*
- c) Në lidhje me pikën tre, kërkojmë të sqarojmë se Spitali Rajonal Durrës ka instaluar 20 kamera dhe 14 prej tyre janë funksionale;*
- d) Përsa i përket konstatimeve në pikën 2, Spitali Rajonal Durrës do të marrë të gjitha masat për përfshirjen në planin e investimeve të përmirësimit të kushteve të ambienteve në të cilat ruan kartelat, me qëllim që të reflektojnë sa më shumë të jetë e mundur standardet e kërkuara. Spitali Rajonal Durrës, bazuar në Statutin e tij të miratuar me VKM me nr.560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar me VKM nr.237, datë 12.04.2006 dhe VKM nr.76, datë 19.01.2007, Rregulloret e Spitalit Rajonal Durrës të azhornuara, është një institucion publik që kryer shërbime publike spitalore dhe mjekësore me buxhet të financuar nga FSDKSH dhe pjesërisht nga të ardhura detyësore, por investimet kapitale janë ekskluzivitet financiar vetëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.*

Në shkresat e paraqitura në seancën dëgjimore dokumentohet rikuperimi i shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë kontrolluesit, konstatohet se nga ana e kontrolluesit duhet përditësuar Formulari i Njoftimit përse i përket rubrikave *“Kategoritë e subjekteve të të dhënave”, “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, “Qëllimi i përpunimit” dhe “Mjetet e përpunimit të të dhënave personale”*. Ky përditësim duhet kryer sa herë kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Kontrolluesi *“Spitali Rajonal Durrës”*, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave*



*personale*" i ndryshuar, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Megjithatë, është marrë në konsideratë fakti që kontrolluesi është treguar bashkëpunues me grupin e kontrollit, ka reaguar pas konstatimit të shkeljeve si edhe ka përmbushur detyrimet për kërkesat ligjore, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 18, 21, 27, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "b", "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit "*Spitali Rajonal Durrës*", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03. 2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "*Spitali Rajonal Durrës*", me gjobë në vlerën 200.000 (dyqindmijë) lekë për shkelje të detyrimeve, përsa i përket marrjes së masave konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme teknike dhe organizative për ruajtjen e dokumentacionit fizik të kartelave shëndetësore të pacientëve në arshivën fizike, parashikuar në nenin 27, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "*Spitali Rajonal Durrës*", me gjobë në vlerën 200.000 (dyqindmijë) lekë për shkelje të detyrimeve, përsa i përket marrjes së masave konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme teknike dhe organizative për ruajtjen e DVR-së, parashikuar në nenin 27, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.
4. Kontrolluesi "*Spitali Rajonal Durrës*", të përditësojë formularin e "*Njoftimit*" dhe të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese për prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), sipas formatit standard të parashikuar në Udhëzimin nr.03/2010 të Komisionerit, brenda një periudhe prej 30 ditësh. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.

6. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 27.05.2019

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

